



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received / Delivery	03.08.2022	viti god Year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPURA	4509/2022		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.546/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.546/2022 të datës 20.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.546/2022 e datës 20.06.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi Kordinator i Zyres Regjionale në Mitrovicë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me datë 20.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3581/2022 të regjistruar me numër A.nr.546/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 3209/2022 të datës 04.05.2022 që ka të bëjë me pëlqime sanitare.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 24.06.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa Këshilli me datë 01.07.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.546/2022 me numër protokolli 3581/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin



Civil të Kosovës të datës 20.06.2022; Vendimi i datës 04.05.2022 me numër protokoll 3209/2022 i nxjerr nga zv. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë; E-mail zyrtar i datës 26.05.2022; Vendimi i datës 03.02.2022 me nr.1013; Përgjigje në kërkesë nga organi i punësimit i datës 01.07.2022 me numër protokoll 3851/2022 bashkë me shkresat e lëndës dhe Vendimi i datës 05.09.2018 me nr.ref.AUV,01 320/2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...", andaj ndërlidhur me këtë Kolegji vlerëson se mbi bazën e arsyeve të kundërshtuara me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.546/2022 e datës 20.06.2022, e parashtruar nga ankuesi është e palejuar.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.546/2022, datë 03/08/2022

Sabile AVDYLI

[Signature]
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

[Signature]
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHC-së.